

Nr. _____ Prot.
__/__/2019

Tiranë, më

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Për: shoqërinë “**HTM**” **sh.p.k** me adresë, Shkodër, Lagja Perash, Rruga Rrojej, Nr. 44, me NIPT K97006004D.

Procedura e prokurimit: “**Procedurë “E hapur- sherbime”**”

Numri i referencës së procedures: Nr. **REF-15806-03-28-2019**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Objekti i prokurimit është “**Paisja me kartela te sigurimit teknik per punonjesit e OSHEE**”, me fondin total 14,960,000 (katermbedhjetë milion e nenteqind e gjashtedhjetë mijë) leke pa TVSH dhe me afat realizimi 12 muaj nga data e nenshkrimit të kontratës.

Publikime të mëparshme: Nuk ka.

Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 13 date 01.04.2019.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët

Njoftojmë se, ka qënë pjesëmarrës në procedurë Operatorët Ekonomik me vlerën përkatëse të ofruara:

- **OE: “TCPE” sh.p.k** me NIPT L52031020F e cila ka paraqitur nje oferte ekonomike me vlere **11,744,000** (njembedhjetë milion e shtateqind e dyzet e kater mijë) leke pa tvsh
- **OE: “HTM” sh.p.k** me NIPT K97006004D, e cila ka paraqitur nje oferte ekonomike me vlere **14,712,400** (katermbedhjetë milion e shtateqind e dymbedhjetë mijë e katerqind) leke pa tvsh.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. **OE: “TCPE” sh.p.k** me NIPT L52031020F per arsyen si me poshte:

Referuar shtojces 8, kriteret e vecanta per kualifikim, pika 5 kerkohet qe:

- *Operatori ekonomik ofertues duhet te kete per 12 muajt fundit, te siguruar nje numer mesatar prej jo me pak se 8 punonjes.*

Per realizimin e kesaj pike Operatori Ekonomik duhet te paraqese:

- *Vertetim te leshuar nga Administrata tatimore per numerin e punonjesve, ne te cilin te jete percaktuar numri i punonjesve te siguruar per secilin nga muajt e mesiperm.*

Referuar vertetimit Nr. T00984294, date 15.04.2019, leshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tirane, rezulton se OE TCPE sh.p.k. ka nje punesim mesatar prej 7,25 punonjesish per periudhen prill 2018-Mars 2019, duke mos permbushur ne kete menyre kriterin e sipercituar.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë shoqërinë **“HTM” sh.p.k** me adresë, Shkodër, Lagja Perash, Rruga Rrojev, Nr. 44, me NIPT K97006004D, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **14,712,400** (katërmbëdhjete milion e shtatëqind e dymbëdhjete mijë e katërqind) lekë pa TVSH, pikët totale të mara 100 pike, është identifikuar si ofertë e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a, me adresë: Bulevardi “Gjergj Fishta”, Ndërtesa Nr. 88, H.1, Njësia Administrative Nr.7, 1023, Tiranë, (Drejtoria e Sherbimeve Mbeshtetëse, Njësia e Prokurimit) kopjen e nënshkruar të formularit të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj siç parashikohet në nenin 58 të ligjit nr.9643, date 20.11.2007 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 25.04.2019

Ankesa: nga shoqëria **“TCPE” sh.p.k.**

KPP me vendimin nr. 381/2019 date 19.06.2019 ka vendosur te mos pranoje ankesen e paraqitur nga OE “TCPE” sh.p.k.